



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenin 2 parag. 2.3 të Ligjit nr. 03/L-049 të Ligjit për financat e pushtetit lokal, nenin 16 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862/18 dhe nenin 6.22 të Rregullores për taksa tarifa dhe gjoba komunale nr. 01-431/04-0014941/18, në kërkesë të subjekteve afariste të cilat janë duke operuar në segmentin e mbyllur në rrugën “Zahir Pajaziti”, për shkak të zhvillimit të punimeve;

Duke i'u referuar shkresës së MAPL nr. 02-129/2 datë 06.02.2020, Nënkryetari i Komunës, merr:

**V E N D I M**

**I.**

Subjektet afariste të cilat zhvillojnë veprimtaritë në rrugën “Zahir Pajaziti”- segmentin rrugor në të cilin janë duke u ekzekutuar punimet për realizimin e projektit “Ndërtimi i bulevardit dhe sheshit 'Sheshi i Dëshmorëve’ në qendrën e qytetit “, lirohen nga ngarkesa komunale për vitin 2020.

**II.**

Lirimi nga ngarkesa i subjekteve të cekura sipas pikës (I) të këtij vendimi bëhet për shkak të mbylljes së segmentit rrugor për realizimin e projektit të cekur, gjendje e cila ndikon drejtpërdrejtë në realizimin e qarkullimit të tyre afarist dhe financiar.

**III.**

Për zbatimin e vendimit kujdesen Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave.

**IV.**

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*U dërgohet:*

*Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik*

*Drejtorisë së buxhetit dhe financave*

*Arkivit*

**Nr. 02-300/01-0013403/20**  
**Podujevë, 20 shkurt 2020**



Nënkryetari i Komunës  
Nexhmi Rudari



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
**Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva**

Në bazë të neneve 13, 17 shkronja f) dhe 58 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040, nenin 5.2 (i) të Ligjit për Ndërmarrjet Publike, nr.03/L-087, nenin 23 (Lista 2 – Stacionet e Autobusëve, nr.2) të Ligjit nr.04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr.03/L-087, neneve 16, 19 paragrafi 1.6 dhe 61 paragrafi 1.3, të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/18, dhe sipas nenit 1 paragrafi 2 të Vendimit nr. 01-020/04-0007443/20 për ngritjen e Komisionit Komunal të Aksionarëve në Ndërmarrjen Publike - Kompania Regjionale e Mbeturinae “Pastrimi” sh.a, të miratuar nga Kuvendi i Komunës së Podujevës, më 31 janar 2020,

Në pajtim me Shkresën nr.prot.02-129/2 të datës 06 shkurt 2020 të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, merr,

**VENDIM**  
**PËR EMËRIMIN E ANËTARIT NË KOMISIONIN KOMUNAL TË**  
**AKSIONARËVE TË NDËRMARRJES PUBLIKE – KOMPANIA REGJIONALE**  
**E MBETURINAVE “PASTRIMI” SH.A.**

**Neni 1**

Anëtar i Komisionit Komunal të Aksionarëve në Ndërmarrjen Publike - Kompania Regjionale e Mbeturinae “Pastrimi” sh.a, emërohet,

***z.Faik Muçiqi, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit***

**Neni 2**

Detyrat dhe përgjegjësit e Komisionit, përkatësisht anëtarit të emëruar, janë të përcaktuara me dispozitat e Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr.03/L-087, Ligjin nr.04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr.03/L-087, Ligjin nr.05/L-009 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike i Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin nr.04/L-111, dhe Ligjin për Shoqëritë Tregtare.

**Neni 3**

Ky Vendim është pjesë përbërëse e Vendimit të Kuvendit të Komunës, nr. 01-020/04-0007443/20 të datës 31 janar 2020.

**Neni 4**


Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*U dërgohet;*  
*Të emëruarit*  
*Anëtarëve të Komisionit*  
*Arkives*

**Nr.02-020/05-0014978/20**  
**Podujevë, 24 shkurt 2020**



**Nënkryetari i Komunës**  
**Nexhmi Rudari**



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
**Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva**

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, Ligjin për Eficiencë të Energjisë nr. 06/L -079, dhe nenin 16 të Statutit të Komunës nr.01-1/298-10, sipas shkresës së MAPL nr. 02-129/2 datë 06.02.2020, Nënkryetari i Komunës, merr:

**VENDIM**  
**PËR FORMIMIN E GRUPIT PUNUES PËR HARTIMIN E PROJEKTEVE PËR**  
**APLIKIM NË FONDIN E KOSOVËS PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË**

**Neni 1**

Për hartimin e projekteve për Komunën e Podujevës, për aplikim në Fondin e Kosovës për Eficiencë të Energjisë, formohet grupi punues, në përbërje:

1. Fidan Restelica, kryesues
2. Fidan Salihu, anëtar
3. Doruntinë Sollova, anëtare
4. Halit Vërshefci, anëtar
5. Ardian Emini, anëtar

**Neni 2**

Grupi punues për punën rreth hartimit të projekteve në formë të shkruar informon Drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit-DSHPMSH.

**Neni 3**

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit

*U dërgohet:*  
*DSHPMSH*  
*Anëtarëve të Grupit punues*  
*Arkivit*

**Nr.02-020/04-0015914/20**  
**Podujevë, 28 shkurt 2020**



**Nënkryetari i Komunës**  
**Behlmi Rudari**